# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-413712**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Një ditë pas kaosit në transportin urban, ndërhyn qeveria: Subvencion 3-mujor, autobusët rikthehen me kapacitet të plotë – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/nje-dite-pas-kaosit-ne-transportin-urban-nderhyn-qeveria-subvencion-3-mujor-autobuset-rikthehen-me-kapacitet-te-plote/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 17:53:24 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 2 shtator 2026, 11:18:25 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `893e07727c8d9aba04f59d930dc705d53a3c40c25461f812756e08fffba98b73` |
| TEKSTI | `c42a58140a84d8eea9b0126f58bfda4a38be5c4ff3072895f8e18b32e9d4bcfa` |
| PAMJA | `1fe4a109e4d26fe4add5b17e818b2e2b41c046724f9a60e159a26f2156e14fb4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f27138e7d4051e4d0384aa450c86abc85debad6fcda942815c435fd22ac66f4e` |
| E MËPARSHMJA | `d4b4e13048c8fec13f479bc6f0831164159ea8e371b2ca8c56e3061a58970ad7` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f27138e7d4051e4d0384aa450c86abc85debad6fcda942815c435fd22ac66f4e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Një ditë pas kaosit të krijuar në transportin urban në Tiranë, pas reduktimit me deri në 30% të numrit të autobusëve, duket se është gjetur një zgjidhje e përkohshme për situatën.

Shoqata e Transportit Urban ka marrë një mesazh nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Ekonomisë, ku bëhet me dije se operatorëve do t'u jepet një subvencion për një periudhë tre mujore.

Pas këtij vendimi, pritet që shërbimi i transportit urban në kryeqytet të rikthehet në kapacitet të plotë, duke rikthyer në qarkullim autobusët që ishin reduktuar gjatë ditës së djeshme.

Reduktimi i flotës me deri në 30% shkaktoi kaos në linjat urbane, me qytetarët që u përballën me pritje më të gjata dhe autobusë të tejmbushur.

Shumë pasagjerë u detyruan të prisnin për një kohë të gjatë në stacione, ndërsa të tjerë zgjodhën të vijonin rrugën në këmbë.

Pse u reduktuan autobusët?

Operatorët e transportit urban e argumentuan vendimin për reduktimin e flotës me rritjen e kostove të operimit, veçanërisht me çmimin e karburantit, i cili sipas tyre vijon të jetë i lartë dhe nuk ka reflektuar ulje të mjaftueshme në treg.

Në një komunikim të mëparshëm me institucionet, shoqatat e transportit urban kishin paralajmëruar se, nëse çmimi i naftës do të vijonte të mbetej

5 "Dhembalja e pjekurisë mund të shkaktojë tumor", kirurgu oral: Kur...

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

në nivele të larta edhe pas periudhës së subvencionimit, do të kërkonej një tjetër mbështetje financiare nga shteti.

Gjatë periudhës mars-maj, operatorët kishin përfituar një subvencion prej 50 lekësh për litër karburant.

Megjithatë, pas përfundimit të kësaj skeme, operatorët pretenduan se kostot e larta e bënin të vështirë ruajtjen e kapacitetit të plotë të flotës, çka solli vendimin për reduktimin e numrit të autobusëve.

#qeveria #Subvencion #transporturban


**Xhuljana Zhuleku**

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.


Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI

**Gjirokastër/ Flakët pranë stallave të...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 22:27



VENDI

**Laçi triumfon ndaj Vllaznisë, kurbinasit...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 20:40



VENDI

**Përfshihet nga flakët banesa në Fushë-...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 20:18

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

● LIVE

**Lajme**
- Politikë
- Bota
- Vendi
- Kronikë
- Lifestyle

**Programe**
- Programe
- Seriale
- Guida TV
- Video
- Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
- Rreth nesh
- Karriera
- Kontakt
- Reklamo me ne
- Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
- Kushtet e përdorimit
- Privatësia
- Cookies
- Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.